

KONTRIBUTI SHKENCOR I AKADEMIK KOLEC TOPALLIT NË REVISTËN SHKENCORE “ALBANOLOGJIA” TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

THE SCIENTIFIC CONTRIBUTION OF ACADEMICIAN KOLEC TOPALLI IN THE SCIENTIFIC JOURNAL “ALBANOLOGJIA” OF THE UNIVERSITY OF TETOVA

Berton SULEJMANI

Abstrakt

Akademik Kolec Topalli është një personalitet i shquar i shkencave albanologjike të kohës sonë. Rezultatet e punës që na i ka lënë, shtrihen në fusha të ndryshme hulumtimi të historisë së gjuhës shqipe. Kolec Topalli e përmbylli veprimtarinë e tij shkencore me një sintezë të gjerë për historinë fonetike, për historinë gramatikore, për historinë e leksikut, siç është *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe* i cili nga shtypi doli në nëntor të vitit 2017. Në këtë kumtesë do të paraqesim kontributin e Profesor Topallit për revistën shkencore “Albanologjia”. Në këtë revistë ai ka botuar këto punime shkencore: “**Parimet themelore të hartimit të alfabetit të shqipes**” dhe “**Vendi i Selman Rizës për shkencat albanologjike**”. Gjatë punimeve të Seminarit XII Ndërkombëtar të Albanologjisë të organizuar nga Universiteti i Tetovës u bë edhe paraqitja e veprës së akad. Kolec Topallit me titull “**Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe**” që e ka botuar QSA-IGJL, Tiranë më 2017. Ndërsa për Kolec Topallin në revistën shkencore “Albanologjia” kanë botuar: Valter Memisha, Anila Omari, Tefë Topalli, Begzad Baliu, Berton Sulejmani, Hana Radoniqi, Edona Jahiu.

Fjalë kyçe: Kolec Topalli, albanologji, “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe”, alfabeti i shqipes, revista “Albanologjia”, gjuhë shqipe, kontribut shkencor.

Abstract

Academician Kolec Topalli is a distinguished figure in contemporary Albanological studies. The results of his scholarly work span various fields of research concerning the history of the Albanian language. He concluded his academic career with a comprehensive synthesis of the phonetic, grammatical, and lexical history of Albanian, most notably with the *Etymological Dictionary of the Albanian Language*, which was published in November 2017. This presentation aims to highlight Professor Topalli's contributions to the scholarly journal *Albanologjia*. In this journal, he published the following scientific articles: “The Fundamental Principles in the Formation of the Albanian Alphabet” and “Selman Riza's Position in Albanological Studies”. During the 12th International Albanological Seminar organized by the University of Tetova, the work of Acad. Kolec Topalli, titled *Etymological Dictionary of the Albanian Language* (published by QSA-IGJL, Tirana, 2017), was also presented. Furthermore, the scholarly journal *Albanologjia* has included academic articles about Kolec Topalli written by Valter Memisha, Anila Omari, Tefë Topalli, Begzad Baliu, Berton Sulejmani, Hana Radoniqi, and Edona Jahiu.

Keywords: Kolec Topalli, Albanology, *Etymological Dictionary of the Albanian Language*, Albanian alphabet, *Albanologjia* journal, Albanian language, scholarly contribution.

1. Të dhëna biobibliografike të akademik Kolec Topallit

Akademik Kolec Topalli është një personalitet i shquar i shkencave albanologjike të kohës sonë. Rezultatet e punës që na ka lënë, shtrihen në fusha të ndryshme hulumtimi të historisë së gjuhës shqipe. Kolec Topalli e përmbylli veprimtarinë e tij shkencore me një sintezë të gjerë për historinë fonetike, për historinë gramatikore, për historinë e leksikut, siç është **“Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe”** që e ka botuar QSA-IGJL, Tiranë më 2017. Madje, do të kisha thënë se janë të paktë studiuesit e llojit të tij që në një jetë njeriu të rrumbullakojnë një sintezë të tillë siç ka pasur fatin Profesor K. Topalli. Një përvojë kaq e madhe dhe e ngjeshur jetësore e hulumtuese do t’i mungojë gjatë shkencës sonë.

Kolec Topalli lindi në Shkodër në vitin 1938, ku kreu edhe shkollën e mesme. Ndoqi studimet e larta në degën e gjuhës shqipe e të letërsisë në Institutin e Lartë Pedagogjik të qytetit të lindjes dhe i përfundoi ato në vitin 1964 në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Punoi si mësues në rrethet Kukës, Lezhë, Gramsh e Krujë dhe njëkohësisht bashkëpunon me institucionet shkencore dhe boton në organet e specializuara, pavarësisht pengesave të shumta që i dilnin nga qëndrimi politik i familjes së tij.

Kolec Topalli ka pasur një karrierë të shquar në fushën e albanologjisë dhe ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në studimet e gjuhësisë shqiptare. Ai ka mbajtur disa pozita të rëndësishme gjatë karrierës së tij. Nga viti 1992 deri në vitin 1997, ai ka shërbyer si Sekretar i Përgjithshëm i Presidentit të Republikës. Pas kësaj periudhe, në vitet 1997–2005, ai ka punuar si punonjës shkencor në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, ku vokacion i punës së tij shkencore kanë qenë: fusha e fonetikës, gramatikës historike dhe etimologjisë së gjuhës shqipe. Më pas, në vitin 2006, ai është bërë këshilltar në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Romë, ndërsa nga viti 2007 deri në vitin 2014, ka qenë koordinator shkencor në Qendrën e Studimeve Albanologjike.

Puna shkencore e Kolec Topallit është e gjerë dhe ka mbuluar tema të ndryshme si fonetika, gramatika historike dhe etimologjia. Ai ka botuar mbi 250 vepra, përfshirë monografi, artikuj, fjalorë dhe referate shkencore, që përmbajnë rreth 10.000 faqe. Ka kontribuar në mbi 30 revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, dhe ka marrë pjesë në 120 konferenca shkencore kombëtare dhe 58 ndërkombëtare, duke dhënë kontribut të madh në studimet albanologjike.

Përveç veprimtarisë shkencore, Kolec Topalli ka qenë gjithashtu një pedagogu i spikatur. Ai ka punuar në universitete të ndryshme, si dhe ka udhëhequr punime të nivelit master dhe doktoraturë. Në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, ai ka dhënë mësim në lëndët, si: Historia e gjuhës shqipe, Fonetika historike dhe Gramatika historike.

Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në albanistikë, ai është zgjedhur anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në vitin 2008, dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në vitin 2012. Ai ka qenë gjithashtu pjesë e komisionit të gjuhës shqipe në ALE (Atlas Linguarium Europae), një institucion ndërkombëtar. Kontributet e Kolec Topallit janë të shumta, ka ndihmuar në avancimin e studimeve albanologjike dhe ngritjen e prestigjit të shkencës shqiptare në arenën ndërkombëtare.

2. Pjesëmarrjet e K. Topallit në Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë si dhe botimet e kumtesave të tij në librat me përmbledhje të kumtesave shkencore të seminarit

Në revistat tona, akademik Kolec Topalli, ka prezantuar e botuar këto kumtesa shkencore¹:

1. **Kolec TOPALLI**, *Parimet themelore të hartimit të alfabetit të shqipes*, Seminari II Ndërkombëtar i Albanologjisë, 22 – 28 shtator 2008, f. 108-112.
2. **Kolec TOPALLI**, *Vendi i Selman Rizës në shkencat albanologjike*, Seminari III Ndërkombëtar i Albanologjisë, 22 – 28 shtator 2009, f. 23-26.

¹ Berton Sulejmani & Defrim Saliiu, *Bibliografi e revistave “Albanologjia” dhe “Filologjia”*, botues: Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2024.

Ndërsa, për akademik Kolec Topallin, janë prezantuar e botuar këto kumtesa shkencore në revistat tona²:

1. **Valter MEMISHA**, *Fjalori etimologjik është një kontribut për historinë e gjuhës, leksikografinë shqiptare, ballkanistikën dhe studimet indoeuropiane*, “Albanologjia”, vol. 6, nr. 11-12, (2019), f. 41-43.
2. **Anila OMARI**, *Fjalori etimologjik i Kolec Topallit – kurorëzim i studimeve të një jete kushtuar historisë së shqipes*, “Albanologjia”, vol. 6, nr. 11-12, (2019), f. 44-49.
3. **Begzad BALIU**, *Profesor Kolec Topalli ishte aq tokësor me jetën dhe po aq qiellor me veprën*, “Albanologjia”, vol. 6, nr. 11-12, (2019), f. 50-53.
4. **Berton SULEJMANI**, *Akademik Kolec Topalli, një personalitet i shquar i shkencave albanologjike*, “Albanologjia”, vol. 6, nr. 11-12, (2019), f. 54-58.
5. **Edona JAHIU**, *Sistemi rasor i emrave të shqipes sipas Kolec Topallit*, “Filologjia”, vol. 9, nr. 15-16, (2021), f. 57-64.
6. **Hana RADONIQI**, *Shpjegimet e Kolec Topallit për theksin në gjuhën shqipe*, “Filologjia”, vol. 6, nr. 9-10, (2018), f. 76-84.

Kolec Topalli, një nga gjuhëtarët tanë të njohur, ka dhënë një kontribut të çmuar në fushën e studimit të alfabetit të shqipes dhe, veçanërisht, në trajtimin e çështjeve fonologjike dhe grafemike që lidhen me përdorimin e alfabetit latin për shprehjen e fonemave shqipe. Një botim i tij i rëndësishëm, është punimi tij shkencor me titull “**Parimet themelore të hartimit të alfabetit të shqipes**”³, të cilin e ka publikuar në librin e përmbledhjeve të kumtesave shkencore të Seminarit II Ndërkombëtar të Albanologjisë të Universitetit të Tetovës. Në këtë punim ka analizuar me thellësi procesin e formimit të alfabetit të shqipes, duke u mbështetur në parimet themelore që u diskutuan në Kongresin e Manastirit (1908), duke e theksuar gjithashtu rëndësinë e respektimit të këtyre parimeve për të pasur një sistem të njëmendtë dhe shkencor të shkrimit të gjuhës shqipe.

Një nga kontributet kryesore të Topallit është analiza e sistemit fonologjik të shqipes, veçanërisht të fonemave që nuk mund të shprehen me shkrimin latin. Në këtë drejtim, ai ka shqyrtuar me kujdes përdorimin e dyshkronjëshave, një zgjidhje që ka mundësuar përfaqësimin e fonemave shqipe që nuk janë të pranishme në gjuhët që përdorin alfabetin latin. Topalli thekson se për të shmangur përdorimin e shkronjave me shenja diakritike, një praktikë e zakonshme në gjuhët sllave, është adoptuar një qasje pragmatike e krijimit të digrameve, që ndihmon në ruajtjen e thjeshtësisë dhe funksionalitetit të alfabetit të shqipes.

Në mënyrë të veçantë, Topalli analizon dy fonemat që paraqisnin vështirësi në përputhje me alfabetin latin, ato të zanoreve **y** dhe **ë**. Ai tregon se përdorimi i shkronjës **y** për fonemën **y** në shqipe, e cila ka një traditë të gjatë në përdorimin e saj që nga periudha e Rilindjes, është në harmoni me praktikën e gjuhëve të tjera evropiane, si anglishtja dhe frëngjishtja. Megjithatë, përveç kësaj, Topalli vë në dukje se përdorimi i **y**-së në gjuhën shqipe mbështetet në traditën e greqishtes së vjetër, ku kjo shkronjë ka një vlerë fonematike të ngjashme me atë që ka në gjuhën shqipe. Ai gjithashtu ndalon te ndikimi i Shoqërisë së Stambollit, e cila ka përdorur këtë shkronjë në të gjitha botimet e saj, si dhe te përdorimi i saj në sistemet e hershme të shkrimit shqip, si ai i Buzukut dhe Kamardës.

Për sa i përket fonemës **ë**, Topalli tregon se përdorimi i shenjës diakritike për këtë fonemë ishte i pazëvendësueshëm, për shkak të ndërlikueshmërisë së saj fonologjike dhe pamundësisë për t'u shprehur me një shkronjë tjetër latine. Ai e justifikon përdorimin e **ë**-së me dy pika (një variant që buron nga tradita arbëreshe) duke theksuar se kjo zgjidhje u gjet në mënyrë të

² B. Sulejmani & D. Saliu, *vepër e cituar*.

³ Kolec TOPALLI, *Parimet themelore të hartimit të alfabetit të shqipes*, Seminari II Ndërkombëtar i Albanologjisë, 22 – 28 shtator 2008, f. 108-112, botim i Universitetit të Tetovës.

natyrshme pas një analize të thelluar të fonemës në kontekstin e shqipes dhe pasi ishin marrë parasysh zgjidhjet e tjera të ofruara nga alfabetet e shoqërive të tjera shqiptare. Në këtë mënyrë, Topalli përkrah parimin e rëndësishëm të Kongresit të Manastirit: "për çdo fonemë, një grafemë", duke e mbajtur alfabetin e shqipes në përputhje me kërkesat fonologjike dhe grafemike të gjuhës shqipe.

Një tjetër aspekt që Topalli e trajton me kujdes është përdorimi i digrameve për bashkëtingëlloret që shqipja ka dhe që latinishtja nuk i mbulon. Ai vë në dukje se shqipja ka 29 fonema bashkëtingëllore, që përveç të tjerave përfshijnë disa të tilla që nuk shprehen me shkronjat latine. Në këtë kontekst, përdorimi i digrameve si **sh, xh, nj, ll** etj. është një zgjidhje inovative që ka pasur ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e alfabetit të shqipes, duke lejuar përfaqësimin e fonemave të veçanta të shqipes pa përdorur shkronja të huazuara ose të modifikuara, të cilat janë të zakonshme në gjuhët sllave. E vetmja bashkëtingëllore që u pranua me shenjë diakritike ishte afrikatja **ç**, e cila përdorej në alfabetin e Shoqërisë së Stambollit. Topalli vlerëson se kjo qasje e krijimit të digrameve ka mbetur një praktikë e qëndrueshme dhe e suksesshme, që ka garantuar një sistem të pasur dhe të pasqyrueshëm fonetiksht.

Në përfundim, zbatimi me rreptësi shkencore i parimeve mbi të cilat u krijua alfabeti i shqipes, i dha lehtësi të madhe atij për të shtypur kudo libra në shtypshkronjat e Perëndimit, meqenëse krahas 25 shkronjave të thjeshta të marra nga alfabeti latin, për të plotësuar fonemat që i mungojnë atij alfabeti, u pranuan 9 digrame, për shkronjat **dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh**, dhe dy grafema me shenja diakritike, për shkronjat **ë** dhe **ç**. I mbështetur në këto parime, alfabeti i shqipes fitoi saktësi për të shprehur numrin e madh të fonemave, më të madh se të gjitha gjuhët që përdorin alfabetin latin⁴.

Në kuadër të përvjetorit të lindjes, përkatësisht 100-vjetorit të lindjes së Selman Rizës, akademik Kolec Topalli, në librin e përmbledhjeve të punimeve shkencore të Seminarit III Ndërkombëtar të Albanologjisë të Universitetit të Tetovës, boton kumtesën e tij shkencore me titull "**Vendi i Selman Rizës në shkencat albanologjike**"⁵ ku jep një vlerësim të thellë dhe analitik për kontributin e këtij dijetari të shquar në shkencat albanologjike. Në këtë kumtesë, Topalli thekson se duhet të jetë detyrë qytetare e çdo shqiptari, por sidomos e gjuhëtarëve, që të nderojnë dhe vlerësojnë Selman Rizën për veprën e tij, që e ka pasuruar gjuhësinë shqiptare dhe ka lënë, veçmas, një shenjë të thellë për historinë e saj.

Selman Riza shfaqet si një personalitet i fuqishëm në shkencat albanologjike që në vitet 1930, ndërkohë që puna e tij më e frytshme filloi në vitet 1950, kur ai nisi thellimin e studimeve mbi gjuhën shqipe, duke iu përkushtuar me veçanti morfologjisë historike. Topalli thekson se lëvrimi i kësaj fushe, që zanafillën e ka në gjysmën e shekullit XIX me veprën e Franz Bopp-it "*Përmbi shqipen dhe lidhjet e saj farefisnore*", ka vijuar me emra të shquar të shkencës albanologjike, si Gustav Meyer, Holger Pedersen, Dhimitër Kamarda, Wilhelm Meyer-Lubke, etj. Por, sipas autorit, një ndër figurat më të shquara dhe ndër të parët që punuan mbi themelet e ngritura të kësaj shkence kryesisht nga gjuhëtarë të huaj, qe Selman Riza. Ai ishte studiuesi i parë shqiptar që iu përkushtua tërësisht këtyre studimeve, duke sjellë kontribute të pazëvendësueshme për hulumtimin e zhvillimit të shqipes, analizën e dukurive gramatikore dhe për studimin e ndryshimeve të sistemit gramatikor të gjuhës shqipe.

Duke e konceptuar gramatikën si skelet të gjuhës, që shërben si një çelës për historinë e saj, Selman Riza dha kontribute të rëndësishme për studimin e ekzistencës, periodizimit dhe rrugës së përgjithshme të zhvillimit të shqipes. Puna e tij mbi autorët e vjetër ka qenë e veçantë dhe me një saktësi shkencore të rrallë, duke e bërë atë një ndër albanologët e pakët që ka thënë fjalën e tij kritike, serioze dhe të rreptë për të gjitha botimet e kësaj fushe.

⁴ Po aty, f. 111-112.

⁵ Kolec TOPALLI, *Vendi i Selman Rizës në shkencat albanologjike*, Seminari III Ndërkombëtar i Albanologjisë, 22 – 28 shtator 2009, f. 23-26, botues Universiteti i Tetovës.

Veprat e Selman Rizës shtrihen përtej këtyre fushave, duke përfshirë aspekte të rëndësishme të gjuhës së sotme shqipe, si gramatikën, drejtshkrimin, alfabetin, ndarjen dialektore, pastërtinë dhe pasurimin e gjuhës shqipe, duke dhënë një kontribut të çmuar për njësimin dhe zhvillimin e gjuhës letrare shqipe. Fusha të tjera që ai ka trajtuar janë historia gjuhësisë së përgjithshme, terminologjia, filozofia e gjuhës, leksikografia dhe hartimi i fjalorëve dhe gramatikave, etj. Ai ka trajtuar gjithashtu çështjet më themelore që lidhen me etnogjenezën e kombit shqiptar dhe origjinën e shqipes, duke mbrojtur me forcë tezën e burimit ilir të shqipes, por gjithashtu duke pranuar edhe një komponent trak, çka nuk përbën kurrfarë pengese për karakterin indoevropian të gjuhës shqipe.

Topalli vë në dukje tiparin themelor të metodës shkencore të Selman Rizës, i cili është argumentimi shkencor i mbështetur në gjuhën e gjallë, në dokumentet shkruara dhe në krahasimet me gjuhët e tjera. Ai përdori ekzemplifikime⁶ të shumta, përfshirë analiza statistikore dhe shqyrtimin e detajuar të materialeve gjuhësore, duke ushtruar një kritikë të rreptë shkencore që çon në nxjerrjen e përfundimeve të peshuara dhe të argumentuara pas analizave të hollësishme.

Për të gjitha këto kontribute të jashtëzakonshme, veprat madhore të Selman Rizës duhet të njihen, të publikohen dhe të studiohen në tërësinë e saj. Duke marrë parasysh tiparet e kohës kur u shkrua, vepra e tij mbetet e pranishme me tërë integritetin e saj edhe në ditët e sotme, kur, siç theksohet në kumtesën e Kolec Topallit, forcat që përpiqen të shtrembërojnë historinë e Kosovës dhe të Shqipërisë e të ndarjes së dhimbshme të kufijve, bëjnë përpjekje të minimizojnë përpjekjet e shqiptarëve për drejtësi shoqërore, mbrojtje të trojeve të veta dhe të kulturës dhe gjuhës së tyre.

Veprat e Selman Rizës dhe përpjekjet e tij për pastërtinë dhe pasurimin e gjuhës shqipe janë të pranishme dhe sot, kur shqipja përpiqet të ruajë identitetin e saj përballë forcave të globalizmit. Ajo ka nevojë të zhvillohet dhe të zhdërvjelltësohet, duke u mbështetur në burimet e saj të brendshme. Selman Riza mbetet një përfaqësues i denjë i mbrojtjes së origjinës ilire të shqipes, në një periudhë kur idetë romantike të origjinës pellazgjike qarkullojnë ende lirshëm, pavarësisht zhvillimit shkencor të gjuhësisë krahasimtare që ka dhënë përgjigje shkencore për këtë çështje.

Selman Riza është një ndër përfaqësuesit më të denjë të albanologjisë dhe të kulturës shqiptare. Jeta dhe puna e këtij shkencëtari, vullneti, këmbëngulja e tij, aspiratat dhe atdhetaria mbeten një shembull i gjallë për të gjithë shkencëtarët e rinj që duan të thonë fjalën e tyre, ashtu siç e tha me plot gojë ai, në kushte kur shpeshherë i imponuan heshtjen.

3. Paraqitja e veprës madhore të gjuhësisë shqiptare, *Fjalorit etimologjik i gjuhës shqipe* (2017) të akademik Kolec Topallit gjatë punimeve të Seminarit XII Ndërkombëtar të Albanologjisë (2018)

Vepra u përrua në hapje të punimeve të seminarit, ndërsa mbi rëndësinë dhe përmbajtjen e saj folën gjuhëtarët nga Tirana, prof. dr. Valter Memisha, prof. dr. Anila Omari; Prishtina prof. dr. Begzad Baliu dhe Tetova, prof. dr. Berton Sulejmani.

Ideja për paraqitjen e veprës madhore të gjuhësisë shqiptare, “*Fjalorit etimologjik i gjuhës shqipe*” (2017) i autorit, akademik Kolec Topalli, na lindi (pra, autorit të kësaj kumtese dhe kolegëve V. Memishës; A. Omarit) në ASHSH ku u zhvilluan punimet e konferencës shkencore ndërkombëtare “*Pikësimi në gjuhën shqipe*” që e organizoi Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë që u mbajt në Tiranë më 30 maj 2018. Bashkë me profesor Memishën dhe profesorin Omari vendosëm që prezantimin e kësaj vepre ta bëjmë gjatë mbajtjes së Seminarit Ndërkombëtar të Albanologjisë, si një ngjarje e rëndësishme e albanologjisë në përgjithësi e, më veçanti e këtyre trevave shqiptare.

⁶ Ilustrime gramatikore dhe leksikore për të mbështetur argumentet e tij shkencore.

Në fund të vitit 2017, akademiku Kolec Topalli, publikoi “*Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe*”, një vepër që u shpërblye me Çmimin “Çabej” si punimi shkencor më i mirë i vitit 2017 në fushën e albanologjisë. Ky fjalor është kulmi i një pune kërkimore që autorit i zgjati mbi 50 vjet dhe paraqet një kontribut të rëndësishëm për albanologjinë e shekullit të XXI. Ai është rezultat i një përkushtimi të pashtershëm, mundi të palodhshëm dhe sakrificash të shumta nga ana e autorit, që ka përballuar vështirësitë intelektuale të shumta gjatë hartimit të tij. Me këtë vepër, akademiku Topalli tregon se si punohet në mënyrë të thelluar dhe kërkimore, si dhe na ofron një model për hulumtimet shkencore në të ardhmen.

Procesi i hartimit të *Fjalorit etimologjik të gjuhës shqipe* ka nisur në vitin 2011 dhe ka përfunduar në vitin 2016, duke rezultuar në një vepër të gjerë prej 1984 faqesh. Në fillim, ishte menduar që fjalori të ishte një punë me disa vëllime, një mundësi që ishte diskutuar edhe në Departamentin e Gramatikës dhe Historisë së Gjuhës, pranë Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë. Megjithatë, autori propozoi dhe realizoi një format njëvëllimësh, i cili ka dëshmuar se është më i përshtatshëm dhe i përkryer për studimet e kësaj fushe.

Ky fjalor paraqet një kontribut të jashtëzakonshëm, jo vetëm për historinë e gjuhës shqipe dhe leksikografinë, por edhe për studimet ballkanike dhe ato indoevropiane. Përpara këtij fjalori, ishin botuar disa studime etimologjike, kryesisht nga autorë të huaj dhe, më vonë, nga shqiptarë dhe arbëreshë, me një kulm të arrirë në hulumtimet e akademikut Eqrem Çabej, një nga figurat më të shquara të gjuhës shqipe. Edhe pse janë realizuar studime të vlefshme, dy fjalorë etimologjikë – njëri në gjermanisht nga Gustav Meyer dhe tjetri në anglisht nga Vladimir Orel – kanë pasur disa mangësi, si për shkak të kohës së hartimit, ashtu edhe për shkak të njohurive të kufizuara mbi gjuhën shqipe. Fjalori i Kolec Topallit vjen për të plotësuar këtë boshllëk dhe për të pasuruar më tej leksikografinë shqiptare dhe studimin e historisë së gjuhës shqipe.

Për përgatitjen e kësaj vepre, akademiku Topalli është mbështetur në një gamë të gjerë studimesh etimologjike dhe kërkimesh të thelluara nga albanologë të shquar, shqiptarë dhe të huaj, të njohur ndërkombëtarisht. Bibliografia e fjalorit përbën një pasqyrë të pasur të këtij hulumtimi, duke përfshirë më shumë se 1000 autorë dhe 297 burime të tjera, përfshirë fjalorë dhe botime të tjera të rëndësishme. Ky fjalor është bërë një burim i domosdoshëm dhe një referencë kyçe për çdo studim etimologjik të gjuhës shqipe.

“Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe” i akademikut Topalli vjen si një vijim i një tradite të gjatë studimesh dhe punimesh të rëndësishme në këtë fushë. Ai vjen pas fjalorit të Gustav Majerit (1891), monografive etimologjike të Joklit (1911, 1923), kërkimeve të Eqrem Çabejt dhe fjalorit të tij të papërfunduar të viteve 1960/70, si dhe fjalorit të Martin Haut me 250 njësi. Po ashtu, ai pason studimet e Bardhyl Demirajt me 400 njësi, ato të Vlladimir Ariout (1998), si dhe punimet e Janes Erart dhe Stjuart Mann-it, dhe shumë hulumtime të tjera të veçanta në fushën e etimologjisë. Fjalori i Topallit është një vepër që mbledh një numër të konsiderueshëm fjalësh dhe ofron shpjegime të shkurtra dhe të qarta, të mbështetura fort në burime bibliografike të autorëve të shquar. Kjo punë sintezë i shton vlerën e mëtejshme studimeve shqiptare, duke ofruar një burim të vlefshëm dhe të domosdoshëm për ata që studiojnë etimologjinë e gjuhës shqipe.

Autori ka zhvilluar kërkime të thelluara dhe të gjithanshme në literaturën etimologjike të botuar, si dhe në disa vepra që ndodhen në Arkivin e Shtetit, të cilat janë të ruajtura në dorëshkrim. Nga këto studime janë krijuar dy skedarë: njëri për fjalët e trashëguara dhe tjetri për huazimet e periudhave historike. Literatura gjuhësore që lidhet me etimologjinë, e cila përfshin 30 faqe në fjalor, paraqet një burim të rëndësishëm bibliografik për studiuesit e ardhshëm të kësaj fushe. Ajo përfshin studimet e hershme, ku gjuhëtarët e huaj kanë dhënë kontributin më të madh, për t’u pasuar nga albanologë të njohur në shekujt XIX dhe XX, si: Gustav Meyer, Holger Pedersen dhe Norbert Jokl, të cilët vunë themelet e studimeve albanistike. Po ashtu, literatura përfshin edhe arbëreshët, Dhimitër Kamarda dhe Marko La Piana, si dhe një sërë studiuesish shqiptarë si: Kristoforidhi, Justin Rrota, Eqrem Çabej, Aleksandër Xhuvani etj. Autori, jo vetëm që ka

përdorur këtë literaturë për hartimin e fjalorit, por ka bërë të mundur edhe identifikimin e autorëve që janë marrë me etimologjinë e çdo fjale, duke dhënë një ndihmesë të çmuar për studimet e ardhshme në këtë fushë. Po ashtu, kur ka qenë e mundur, janë shënuar gjuhëtarët që kanë ofruar për herë të parë burimin e saktë të fjalës, duke respektuar gjithmonë kontributet e tjera të autorëve dhe duke mbajtur etikën shkencore, që kërkon paraqitjen e mendimeve të ndryshme dhe, ndonjëherë, edhe të kundërta.

Fjalori përmban fjalë të mbarë gjuhës, dialektore, krahinore e lokale; fjalë të gjuhës së shkruar, bisedore, familjare e poetike; arkaizma, historizma e neologjizma; leksikun e autorëve të vjetër; fjalë të parme, të prejardhura, të përngjitura e kompozita; toponime, hidronime, antroponime e patronime me burim nga apelativa etj. Kam veçuar disa nga mikrotoponimet që kanë shtrirje edhe në trevat shqiptare të Maqedonisë (nga viti 2018 Maqedonia e Veriut) të përfshira në fjalor, si:

ARÍ m. “kafshë e egër gjitare e mishngrë-nëse e pyjeve tona”. Fjalë e mbarë gjuhës, e trashëguar nga indoeuropianishtja. Ka depërtuar në toponimi: **Livadhi i Arushës** në Mitrovicë (Kosovë), **Lugu i Harushës** (Plavë), **Kepi i Arushës** (Pu-kë), **Grik’e Ariut**, **Shkëmb i Ariut**, **Vër’e Ari-ut** (Kurvelesh), **Shpella e Arushës** (Malësia e Tetovës)⁷.

MAGJÁR m. “gomar, lat. *Equus asinus asinus*”, “urës zjarri”, “urëz e veglave muzi-kore me tela”. Formë krahinore, sidomos e anëve të Mirditës, për *magar*, që ka lidhje me emrat më të vjetër të kësaj kafshe: *agër* (m.), *gare* e *agërinjë* (f.). Trajta e gjinisë femërore *magjaricë*, me prapashtesën *-icë* të mocionit. Rrjedhoja: **magjarkë** “lopë e kuqe”, **magjarec** “hekuri i zjarrit ku mbështeten drutë”. Ka de-përtuar në toponimi: **Rrethmagjari** në Bukë-mirë të Mirditës, **Gjuri i Magjarit** në Malësi të Tetovës, **Përroi i Magjarit** në Pukë. Përdo-ret si patronim në anët VL.

(Bibl.: Stier nr. 38, Meyer EW 253, Barić ARS I 54, Mladenov Reč. 289, Brâncuș SCL 3, 1961, 199, Çabej SF 3, 1964, 15, Ajeti SG I 82, Orel AED 240)⁸.

Ai përfshin gjithashtu edhe disa fjalë të vjetra të shqipes, të cilat, megjithëse mund të kenë dalë nga përdorimi në gjuhën e sotme, janë ruajtur në rrjedhojat e krijuara prej tyre ose në toponimi, duke shërbyer si tregues të pasurisë leksikore të shqipes. Për fjalët e reja që kanë hyrë në gjuhën shqipe nëpërmjet librave, fjalori ka shpjegime për një pjesë të madhe të tyre, për ato fjalë që kanë hedhë rrënjë në gjuhë duke krijuar rrjedhoja me mjetet fjalëformuese të shqipes.

ANKÓJ fol. Përdoret më tepër në formën joveprore *ankohem* me kuptimin “shpreh dhi-mbje për një sëmundje ose pakënaqësi për diçka”. Fjalë e dialektit gegë, sikurse e dësh-mon ruajtja e paerrësuar e zanores *a-* në ballë të fjalës para një sonanteje hundore. E kanë edhe arbëreshët e Italisë. Sot është përgjithë-suar për mbarë shqipen. Është formim i brend-shëm me prapashtesën *-o* nga një rrënjë **ank-*, që brenda gjuhës lidhet me *ankth* (*ank-th*). Një lidhje tjetër brendagjuhësore është me *rënkuj*, që ka kuptim të njëjtë dhe është formuar nga po ajo rrënjë me parashtesën *r-*. Lidhja tjetër është me *angullin* “kuit qeni, ulërin”, edhe kjo nga rrënja *ang-* me të njëjtin kuptim. Dësh-mohet së pari te Buzuku: *ju të klani e të anë-koni*. Budi e ka me aferezë të zanores nistore: *plot vāj e plot nëkime* (DC). Edhe Bardhi ka formën e Budit me aferezë: *Me u nëkuem*. Rrjedhoja: **ankim**, **ankues** (Bardhi); **ankesë**, **të ankuemit**, **i ankueshëm** (Bashkimi); **ankojë** “ankues” (Gazulli). Në Kërçovë e Strugë (Maqedoni e Veriut) **nëkoj** “qaj, vajtoj” me rënie të zano-res nistore. Neologjizma të kohëve më të reja janë termat juridikë **ankimuj**, **ankimim**, **anki-mor**, **ankimtar**.

(Bibl.: Meyer EW 301, Jokl IF 43, 1926, 62, Çabej SE IV 50, Ashta LH I 249, LH II 249, LH III 94, Demi-raj AE 78, Orel AED 6, Luka I 100)⁹.

BURG m. Fjalë e mbarë gjuhës me shumë kuptime: “ndërtesë ku mbahen ata që janë dë-nuar

⁷ Kolec Topalli, *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*, f. 118-119, QSA, IGJL, Tiranë, 2017.

⁸ Po aty, f. 926.

⁹ Po aty, f. 105-106.

me heqje të lirisë”, “qilar ku ruhen ushqi-me e pije”, “haur bagëtish”, “errësirë e ma-dhe”, “kodër e vogël”, “shkëmb i thepisur”, “varr”. Nga të gjitha kuptimet e fjalës, më i hershëm duket ai i një vendi ku mbahen të burgosurit, që lidhet me lat. *burgus*, me kupti-min “kështjellë”, prej saj “qytet i vogël, lagje periferike” (khs. it. *borgo*). Dihet se burgjet mesjetare kanë qenë brenda kështjellave, të ci-lat ndërtoheshin gjithnjë majë kodrave. Pran-daj nga *burg* “vendi i nëndheshëm i kështje-llës ku mbahen të burgosurit” rrjedhin kupti-met “qilar”, “haur”, “errësirë”, “varr”; ndërsa nga kuptimi “kështjellë majë kodrës” rrjedhin “kodër”, “shkëmb”, “shpellë”, që dalin sido-mos në toponiminë e Shqipërisë së Veriut: **Krepi i Burgut, Burgu Gurajt, Burgu Vrihit, Burgu i Lugjeve, Burgu i Ferrës, Burgjës, Suka e Burgakeqit, Burgdobërçet, Burg-krymbëça** etj. Emri i fshatit **Burgajet** (Mat) është *burg-ajë-et*, me dy prapashtesa (khs. *dushkajë*). Përdoret edhe si emër familjeje (**Burgaj**). Një shumës i singularizuar është **burgj** e Tetovës, që përdoret për “errët, terr”. Dëshmohet së pari te Buzuku: *e shti! endë burg*. Ky autor ka edhe *burgëtar* për “i burgo-sur”, që në Malësi të Madhe del me kuptimin “i mjerë”. Rrjedhoja: a) me prapashtesa: **bur-goj** e **burgim, burgos** e **burgosje, burgëtoj** “ia bëj jetën burg” e **burgëtim, burgtar** “i mjerë, i shkretë” (Bashkimi), **burgateshë** “e mjerë, fatzezë” (Dema), **burgel** “vend i errët” (Xhu-vani), **burgaxhi** (me përbuzje), **burktohem** “mbyllem brendë” (Kelmend); b) me para-shtesa: **paraburgim** e **paraburgos; zhburgoj** e **zhburgim, zhburgos** e **zhburgosje**. Çabej emrin *burg* e afron me gjerm. *bergen* “fsheh”, rus. *beregù* “kursej, ruaj”.

(Bibl.: Stier nr. 167, Miklosich AF II 7, Meyer EW 54, Helbig 43, Jokl ZONF X 1934, 183, Çabej SE II 379, Mann ICD 112, Orel AED 42, Bonnet 369)¹⁰.

BURANÍ f. “gjellë me barishte të grira, si-domos me spinaq”. Huazim nga turq. *buraní*, me burim prej persishtes. Nëpër të folme dia-lektore del me forma të ndryshme: **borroní** në Berat, **baraní** në katundet e Tiranës, **baranojë** “gjellë me hithra” në Shkup, me prapashtesën *-onjë*, **boronik** në Përmet. Prej turqishtes ka hyrë edhe në gjuhë të tjera ballkanike e joball-kanike (sp.).

(Bibl.: Miklosich TEN I 18, Lokotsch 358, Skok ER I 188, Boretzky TE II 29, Çabej SE II 286, Ndreca 105, Dizdari Fj. 123)¹¹.

CING psth. Përdoret në shprehjet: *s’bëri cing me gojë; as cing, as ming, cingra-min-gra*. Fjalë onomatopeike, ku *ming* bën rimë me *cing*. *Cingra-mingra* me formantin *-ra* të shumësit të toskërishtes. Rrjedhoja: **cingthi** “mënyrë të ecuri me njëren këmbë” me prapa-shtesën *-thi*; **cingëllon** “nxjerr një tingull të hollë, tringëllon” me emrin **cingëllimë**. Nga kjo rrënjë, **cingare** “zile bagëtish”, me përhap-je kryesisht në gegërishte (Dukagjin, Lumë) me prapashtesën *-ar(e)*, e afërt me **cigremë** e **cingremë** “zile e madhe”, me **cingron** “kuis, pingëron” dhe emrin **cingërimë**. Këtyre u për-gjigjen në Jug **cingërlaqe** “zile e vogël” (Li-bohovë) me prapashtesat *-lë + -aqe* dhe **cin-gëliqe** (Skrapar, Myzeqe). Në Has **cingelinge** “cingare vjetash, kumbonë viçash”, në Gosti-var **cingël** “zile”, në Plavë e Guci **cingla** e **cinglore** “varg zbukurimi me cingla a stoli të ndryshme”, në Malësi të Tetovës **cingët** e **cin-gllon** “qan pa lot me zë të ulët”. Në këtë çer-dhe fjalësh hyjnë: **cingonë** e gegërishtes (Ba-shkimi) për “gajde, pipëz, curle” me prapash-tesën *-onë* (khs. *zefonë*) me ndikim të *kumbo-në-s*, **cingëlimë** “cingare, zile”. Emri *cingare* ka depërtuar në disa të folme serbe.

(Bibl.: Çabej SE III 41, Luka I 264, S. Hoxha 66, Dizdari Fj. 138)¹².

CIRILÁNG m. “shëllirë e hollë djathi”. Fjalë dialektore e gegërishtes (Mirditë, Kukës, Tropojë, Kosovë). Formim i brendshëm me emrin *lang* dhe elementin parashtesor *ciri-*, që mund të jetë ndikuar ose formuar nga *spirë* “heqje barku, diarre”, “supë fare e hollë e pa shije”; khs. *spirilang* (Shkodër)¹³.

¹⁰ Po aty, f. 273-274.

¹¹ Po aty, f. 272.

¹² Po aty, f. 303.

¹³ Po aty, f. 306.

Duke dhënë shpjegime për pjesën më të madhe të fjalëve të shqipes (kupto të burimit vetjak të saj) të përfshira në këtë fjalor, të cilat kanë edhe shtrirje mbarëkombëtare, me këtë rast, do të doja të veçoja dhe t’jua ilustroj me një fjalë të mbarë shqipes, fjalën BESË, fjalë e shqipes që është pjesë edhe e gjuhës artificiale ESPERANTO. BESA ose mbajtja e fjalës së dhënë për diçka me rëndësi ose fjala e nderit për të zbatuar medoemos një detyrim të marrë përsipër, gjithashtu për zbatimin e rregullave të marrëdhënieve të bashkëjetesës në krahinë, në përputhje me doket dhe zakonet e vendit. Historikisht, kjo fjalë, ka përfaqësuar dy anë të lidhura: një virtut moral dhe një institut të së drejtës dokesore të trashëguar. Besa si virtut moral e ka zanafillën nga lashtësia, si nevojë për solidaritetin në bashkësinë fisnore a fshatare. Ja shpjegimin që e jep fjalori:

BËSË f. “fjala e dhënë, premtim”. Fjalë e mbarë shqipes, që e kanë edhe arbëreshët. Formim i brendshëm, mjaft i lashtë, nga emri *be* dhe prapashtesa -së (Treimer). Dëshkohet së pari te Buzuku: *Gruo, kī besë muo*. Për dialektin jugor, Matrënga: *çë pistepsn ti për be-sët*. Rrjedhoja: a) me prapashtesa: **besoj** (te Buzuku), **besim**, **besimtar** e **mosbesim**; **i besu-eshëm** e **besueshmëri**; **besnik** (Bogdani), **besnikisht** (Da Lecce), **besnikëri** e **besnikërisht**; **besar** “i besueshëm”, **besatar** “besnik”, **besa-tohem** “lidhem me besë” me emrin **besatim**, **besëtor** “besnik”, **besëtar** “ndërmjetës për paj-tim gjaqesh”, **besëni** / **besëri**, **besullor**, **i besëm** “besnik”, folja **besënj** e ndajfolja **besurisht** (arb. e Italisë); b) me parashtesa: **i pabesë** (Buzuku), **pabesí**, **pabesisht**, **i pabesuar**, **i pabesueshëm**, **shpabesem** nga *sh-pa-besë*; si edhe shumë kompozita (**besëkeq**, **besëlidhje** etj.). Emrat **Besë**, **Besnik**, **Besim**, **Bestar** përdoren si antroponime. Si fjalë e lashtë e shqipes, ka hyrë edhe në gjuhë të tjera ballkanike, si në greqishten e re, në rumanishte, në arumanishte, në serbishte e deri në turqishte, ku emri *besa* ka kuptimin “armëpushim ndërmjet dy personash”.

(Bibl.: Camarda I 58, Bugge BB XVIII 1891, 163, Meyer EW 33, Pedersen KZ 36, 1900, 308, Wiedemann BB XXVII 1902, 201, Jokl LKU 262, Schmidt KZ 57, 1930, 26, Tagliavini AD 81, Treimer KZ 65, 1938, 110, Walde-Hofmann I 494, Skok ER I 140, Petriceicu-Has-deu EMR 1, 91, Çabej Hyrje II 169, SE II 204, Ajeti SG I 1982, 58, Huld BAE 42, Mann ICD 70, Brâncuş Voc. 131, Demiraj AE 96, Orel AED 22, Matzinger Fest. Fiedler 2005, 115)¹⁴.

Edhe pse ndriçimi i prejardhjes së fjalëve të gjuhës shqipe paraqet vështirësi të mëdha, autori i fjalorit nuk ka hezituuar të përballët me etimologji komplekse, të pazgjidhura ose të mbetura pezull. Ai ka ofruar shpesh më shumë se një hipotezë për secilën fjalë, duke e mbështetur çdo propozim me argumente të qarta dhe të thella, të ndihmuara nga aparati shkencor i duhur dhe intuita e tij e shprehur si gjuhëtar. Ky fjalor pasqyron nivelin e arritur në studimet etimologjike të gjuhës shqipe dhe shërben si një bazë shkencore e fuqishme për brezat e ardhshëm të studiuesve, të cilët do të kenë mundësinë ta zhvillojnë dhe thellojnë më tej këtë fushë. Pa dyshim, këta breza do t’i jenë mirënjohës akademik Kolec Topallit për këtë trashëgimi të çmuar që ka lënë pas.

Referencat

- [1]. “**Albanologjia**”, vol. 6, nr. 11-12, botues: Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2019.
- [2]. “**Filologjia**”, vol. 9, nr. 15-16, botues: Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2021.
- [3]. **Libri i përmbledhjeve të punimeve të Seminarit II Ndërkombëtar të Albanologjisë**, 22–28 shtator 2008, botues Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2008.
- [4]. **Libri i përmbledhjeve të punimeve të Seminarit III Ndërkombëtar të Albanologjisë**, 22–28 shtator 2009, botues Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2009.
- [5]. **Sulejmani, Berton & Saliu, Defrim**, *Bibliografi e revistave “Albanologjia” dhe “Filologjia”*, botues: Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2024.
- [6]. **Topalli, Kolec**, *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*, QSA, IGJL, Tiranë, 2017.

¹⁴ Po aty, f. 197.